



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 1000 Prot.

Tiranë më, 10.05.2022

Lënda: Mbi procedurat e lëvizjeve paralele sipas udhëzimit nr.12 datë 10.06.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”.

DREJTORIVE RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

ZYRAVE VENDORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Bazuar në Ligjin nr. 7961, date 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në Ligjin Nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Urdhrin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr 31 datë 28.01.2020, “Për Miratimin e Rregullores për Funkcionimin e Institucioneve Arsimore”, Udhëzimin Nr.12, datë 10.06.2021, të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, të Udhëzimit Nr.30 datë 12.09.2018, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”,

Në vijim të punës për zbatimin e Udhëzimit Nr. 12, datë 10.06.2021, Drejtoritë Rajonale, Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe Institucionet e Arsimit Parauniversitar Publik duhet të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në udhëzim si më poshtë:

1. Afati i dorëzimit të dosjeve nga mësuesit që dëshirojnë të kryejë lëvizje paralele para fillimit të vitit mësimor 2022-2023 është deri nga data **01 Qershor 2022- 30 Qershor 2022**
2. Mësuesi dërgon me postë në ZVAP ku është i punësuar kërkesën dhe dokumentacionin e njëzuar me origjinalin (i noterizuar) sipas shtojcës 2.1 të Udhëzimit nr.12.
3. Procedura e vlerësimit të dosjeve të mësuesve që mbeten pa ngarkesë mësimore, për vitin 2022-2023 në nivel shkolle të kyhet brenda datës 15.07.2022 duke u mbështetur rigorozisht në kriteret e shtojcës 2.1 të Udhëzimit Nr.12 datë 10.06.2021 “Për procedurat e pranimit e

- të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”.
4. Drejtuesi i institucionit arsimor, pas vlerësimit të dosjeve dhe pikëzimit në nivel shkolle të mësuesve që rezultojnë pa ngarkesë mësimore sipas profilit përkatës, brenda datës 15.07.2022, përcjell zyrtarisht në ZVAP nga varet, dosjen/t e mësuesit/ve që rezultojnë pa ngarkesë mësimore për vitin 2022-2023 me dokumentacionin përkatës sipas shtojcës 2.1.
 5. Kërkesat për lëvizje paralele me dëshirë, të dërguara në ZVAP përkatëse brenda datës 30.06.2022 do të vlerësohen sipas pikëve në dokumentacionin përkatës të aplikantit, së bashku me kërkesat për lëvizje të detyrueshme në çdo profil dhe do të listohen në rend zbritës, së bashku me kandidatët që mbesin pa ngarkesë mësimore në rend zbritës duke filluar nga kandidati me më shumë pikë, brenda datës 31.07.2022.
 6. Lista e hartuar nga komisioni i vlerësimit të dosjeve, e miratuar nga titullari i ZVAP-së, shpallet në faqen zyrtare të ZVAP-së brenda datës 31.07.2022 dhe një kopje e saj përcillet në DRAP dhe DPAP, brenda datës 02.08.2022, e skanuar dhe në formë zyrtare.
 7. ZVAP, pas njoftimit të DRAP si më lartë, kryen procedurat e lëvizjeve paralele të detyrueshme/dëshirë për çdo profil në përputhje me vendet vakante në institucionet arsimore vartëse në profilet përkatëse, në afatin 03.08.2022-15.08.2022. Kjo listë duhet detyrimisht të bëhet publike në faqen zyrtare të institucionit dhe t’i dërgohet DPAP për publikim në portalin ‘Mësues për Shqipërinë’ sipas pikës 6 të kreut I.
 8. Në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele në nivel ZVAP-je, nëse ende rezultojnë vende vakante, dërgohen zyrtarisht në DRAP brenda datës 16.08.2022, për t’u shpallur si vende të lira për punësime me kontrata definitive/provizore me aplikantë nga portali për vitin mësimor 2022-2023.

Sqarim

- Në procedurën e pikëzimit të mësuesve që rezultojnë pa ngarkesë në nivel shkolle dhe ZVAP të përdoret me rigorozitet tabela 2.1 e Udhëzimin Nr.12 datë 10.06.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”.
- Për sa i përket pikës 4 të shtojcës 2.1 duhet të merren parasysh kriteret si: Nëse mësuesi aplikant për lëvizje paralele ka marrë shkallën e kualifikimit para vitit 2007 dhe e ka të shënuar në mënyrë të rregullt në librezën e punës, me firmë e vulë të njomë si dhe paraqet dëshminë apo është në regjistrat e kualifikimit të ish-DAR/ZA-ve, do të vlerësohet me pikë maksimale, kategoria e parë me 10 pikë.
- Nëse mësuesi aplikant e ka të shënuar shkallën e kualifikimit në librezë pune të përfutur pas vitit 2007 por nuk e disponon fizikisht si dëshmi, atëherë ZVAP përkatëse i drejtohet zyrtarisht organit përgjegjës ASCAP, e cila i vendos në dispozicion ZVAP-së shkallën e kualifikimit të punonjësit arsimor.

- Nëse në nivel shkolle, mësuesit renditen me pikë të barabarta, prioritet për të qëndruar në institucion arsimor ka mësuesi me aftësi të kufizuara, dhe nëse nuk jemi para një rasti të tillë, si kriter ndarës përdoret pika 10 e kreut VII (Nëse për një vend pune janë dy mësues me pikë të barabarta, përzgjedhja bëhet duke vlerësuar me radhë: vjetërsinë në punë, shkallën e kualifikimit, vlerësimin e kualifikimit të fundit dhe, në rastin kur dy mësuesit përsëri rezultojnë me tregues të njëjtë, me short)
- ZVAP-të, do të përfundojnë procedurat për lëvizje të detyrueshme/dëshirë brenda datës 15.08.2022.
- Bashkëlidhur kësaj shkrese gjeni edhe tre modelet e shtojcave për vlerësim nga drejtori i shkollës, prindërit dhe punonjësi i shërbimit psiko-social.

Faleminderit për bashkëpunimin.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

REZARTA PULLAZI

